



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Durrës, më 04.09.2024

**PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me datë 03.09.2024 në Durrës, nga ana e njësisë së prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 8349/1 prot., datë 27.08.2024, me qëllim zbardhjen e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të kërkesave të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit "E hapur e thjeshtuar", me të dhënat si më poshtë vijon:

OBJEKTI I PROKURIMIT: "F.V Skenë Fikse Ne Sallen Black Box Të Shkollës J.Kukuzeli"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Emërtimi dhe identifikimi i Kodit CPV: Punime ndërtimi për skena- 45237000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.682.625 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzetë e pesë) lek, pa tvsh.

Argumentim:

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË
KONTRATËS**

Në zbatim të urdhrin të grupit të specifikimeve nr.223, datë 05.07.2024 të titullarit të autoritetit kontraktor, "Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm", të planifikuar për t'u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

- Dokumenteve sipas buxhetit të bashkisë të vitit 2024 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
- Shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i punës.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet tenike të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastruktures , objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” neni 36.

PERLLOGARITJA E VLERES LIMIT TE KONTRATES

Për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM, Nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sipas të cilit:

Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara

Në përfundim të punës së grupit u vërejt se:

Grupi i punës u bazua në: projektin dhe preventivin për projekt zbatimin e objektit: “F.V Skenë Fikse Ne Sallen Black Box Të Shkollës J.Kukuzeli”.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se:

Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull: “F.V Skenë Fikse Ne Sallen Black Box Të Shkollës J.Kukuzeli” rezultoi të jetë: 1.682.625 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzetë e pesë) lek neto pa tvsh.

Mbështetur në rezultatin e sipër nxjerr, komisioni **me unanimitet,**

Afati i realizimit të punimeve është 18 (tetëmbëdhjetë)ditë, sipas grafikut të punimeve.

Garancia pr mbulimin e difekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.*

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (sipas shtojcës 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 600’000 lek.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e kërkuara të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenin 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, ligjin nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” neni 3.1(a,b,c). Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Dokumentet e kërkuara më sipër, do të paraqiten nga operatori ekonomik fitues para dhënies së kontratës ose nëse kërkojnë sqarime nga A.K.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:
- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 500'000 Lek, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
 - punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 2'000'000 lek.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, *të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9*.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/a, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit të kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 55, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar:

- .3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-2A - Ndertime civile dhe industrial.
- NS-4A - Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve

KATEGORIA E KËRKUAR	PERSHKRIMI I KATEGORISË SIPAS LEGJISLACIONIT TË FUSHËS	ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE	NIVELI I KLASIFIKIMIT I KËRKUAR PËR KATEGORINË RESPEKTIVË	VLERA E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE
NP-2 A	Ndertime civile dhe industriale	Shtrese lluster cemento 1:2 per taracen , Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese K Katrama per taracen , Struktura te holla monolite betoni C 20/25 + bordura betoni, shtrim me pllaka gur trani etj..	A, 0-20 milion lek	3 792 135.5 Lek
N.P.11-A	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e tensionit të lartë dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike	FV Ndricules ne forme spoti LED 22W jashte murit tualete, Ndricules Panel Led 60x60cm 31W , F.V kuti shperndarese me kapak plastike 118x96x50mm , FV kuti kapak dhe suport 3M per montim brenda murit etj ...	A, 0-20 milion lek	1.641.555,7 Lek
NS-1 A-	Punime per prishjen e ndertimeve	Heqje pllaka dysHEMEJE , Prishje suvatimi muri i brendshem , Heqje e parapetit te xhamit mbi strehe , heqje tavan i varur me kartonxhes.	A, 0-20 milion lek	309 819,3 Lek

NS-2 A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	Punime per sistemin e MNZ, Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit,	A, 0-20 milion lek	329 199,6 Lek
NS-4 A-	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.	Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60, Patinim muri me stuko , Suva brenda mur tulle , Lyerje tavani me boje hidroplastike , Boje hidroplastike importi cilesia I , F.V parapet xhami i temperuar, F.V dyer te brendshme, Vetrat xhami i temperuar.	A, 0-20 milion lek	1.684.022,2 Lek
N.S.18-A	Punime topogjeodezike;	Është kërkuar për arsye të zbatimit të rilevimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt.		
N.S.12-A	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit	Sistemi i kondicionimit dhe ajrimit , F.V Njesi e jashme pompe nxehtesie VRF , F.V njesi e brendshme kasete , Tubacione bakri + termoizolim , Aspirator i presionit te mesem etj....	A, 0-20 milion lek	2.044.727,5 Lek

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier Ndertimi 1 (një)

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. Inxhinier Elektrik 1 (një)
b. Inxhinier Gjedoet 1 (një)
c. Teknik ndertimi 1 (një)

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a. Drejtues Mjeti 1 punonjës
b. Elektricit 2 punonjës
c. Pllakashtrues 2 punonjës
d. Hidroizolues 2 punonjës
e. Specialist suvatimesh 2 punonjës
f. Bojaxhi 1 punonjës
g. Punëtoore ndertimi të thjeshtë 12 punonjës

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së cakëllit ,stabiliznatit si dhe shtresat e tapetit si asfalt dhe binder Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve konkretisht cakëll,stabilizant binder dhe asfalt.
- **Inxhinieri gjeodet** është kërkuar me qëllim realizimin e rlevimeve topografike te domosdoshme gjatë zbatimit.
- **Inxhinieri i Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit elektrik për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin punimeve elektrike.
- **Tekniku i Ndertimit** është i nevojshëm për ndjekjen nga afër të gjithë punimeve ndërtimore ne baze të zërave te preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike te zbatimit si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës në kantierin e ndërtimit.
- **Drejtuësit** e mjetit janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion dhe autobetoniere
- **Elektracistët** janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve elektrike.
- **Pllakashtruesit** janë të nevojshëm per punimet e shtrimit të pllakave
- **Hidroizoluesit** janë të nevojshëm për realizimin e zërave të hidroizolimeve të ndryshme sipas projektit, shtresat përkatëse sipas projektit.
- **Specialist suvatimesh** jane te nevojshem per suvatimin e mureve te brendshme , punimin e kartonxhesit .
- **Bojaxhiu** jane te nevojshem per lyerjen e interierit.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 26 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri prej 26 punonjës përfshin 12 punëtorë të thjeshtë +14 personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve,drejtuës mjeti etj të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu per llogaritjen e numrit te punonjesve jane marre parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	SASIA
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 3.5-7.5 ton	1 copë
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton	1 copë
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar mbi 18 ton	1 copë
Autobetoniere	1 copë

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumetimi: Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punës së mjeteve .

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në Ndërtim” dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë:

- ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të cilësisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- Certifikat: ISO 45001 - Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës, certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojtë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes

së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

2.4.2 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhënat e mëposhteme:

Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri	Bashkia Durrës
Adresa	Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks	052 22 23 10
E-mail	info@durres.gov.al

Ueb-faqe www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Pune

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-17952-09-04-2024

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “F.V Skenë Fikse Ne Sallen Black Box Të Shkollës J.Kukuzeli”

5. Fondi limit: 1.682.625 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 18 ditë

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 16.09.2024 Ora: 10:00

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Elio Jani

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarëve të njësive kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit